Pml.nr.171/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa kryetare e kolegjit, Nesrin Lushta dhe Enver Peci, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve A.B. dhe E.C., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.9 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit A.B., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.183/2017 të datës 29.5.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1069/2017 të datës 9.6.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 17.7.2017, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit A.B., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.183/2017 të datës 29.5.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1069/2017 të datës 9.6.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.183/2017 të datës 29.5.2017, të pandehurve A.B. dhe E.C., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.9 të KPK, i ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj, e cila do të llogaritet nga data 30.5.2017 deri më datë 30.7.2017. Masa e paraburgimit është vazhduar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPK-së.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit A.B., mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN1.nr.1069/2017 të datës 09.06.2017, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit A.B., av. A.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitës 384 par.1 nënpar.1.12 dhe par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2, dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës aktvendimet e atakuara t'i anulojë dhe të pandehurin A.B. ta lirojë që të mbrohet në liri gjatë procedurës penale ose masën e paraburgimit ta zëvendësojë me masën e arrestit shtëpiak.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi kryesisht thekson se aktvendimet e atakuara janë të pabazuara, ngase në të dy aktvendimet jo që nuk është dhënë ndonjë arsyetim apo ndonjë fakt vendimtarë por edhe ai pak arsyetim që është dhënë vjen në kundërshtim me vetveten dhe me veprimet e ndërmarra gjerë më tani, ngase nga momenti kur është vazhduar paraburgimi janë krijuar rrethana të reja, se i pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë dhe një pranim i tillë është aprovuar nga ana e Kryetarit të Trupit Gjykues, andaj i pandehuri nuk duhet të mbetet pezull gjersa të përfundojë kjo çështje penale për të akuzuarin tjetër dhe të qëndrojë ende në paraburgimit. Gjithashtu thekson se nuk ekzistojnë kushtet për vazhdimin e paraburgimit nga se të pandehurit i dihet vendbanimi, identiteti, nuk ka histori kriminale, është njeri familjar, është penduar shumë dhe ka një fëmijë të sëmur i cili vuan nga çrregullimi pervaziv Alalia dhe se njëra nga arsyet që e ka shty të kryej veprën penale është edhe nevoja e të hollave për shërimin e fëmijës. Kërkesës ia ka bashkangjitur raportin mjekësor për A.B. të datës 2.6.14 nga Klinika për neurologji dhe psikiatri me diagnozë çrregullim pervaziv Alalia, hypophrenia (sjellje hiperaktive).

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.39/2017 e datës 12.7.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo - juridike nga shkresat e çështjes, kryesisht nga aktakuza PP/I.nr.586/2016 të datës 26.5.2017, raporti mbi vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, raporti njoftues i datës 1.11.2016, raporti plotësuese i datës 2.11.2016, raportet mbi ekspertimin të datës 24.2.2017 dhe 10.3.2017, foto dokumentacion dhe foto albumi, si dhe provat tjera të mbledhura gjerë më tani, rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprës penale për të cilën dyshohet, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 të KPPK, për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPPK, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i ikjes, fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se vepra penale për të cilën dyshohet është e një natyre mjaft të rëndë, e nëse i pandehuri shpallet fajtor, parashihen dënime mjaft të larta, ashtu që i pandehuri po të lihet në liri mund të jetë i paarritshëm për organet e ndjekjes e një gjë e tillë është shumë e lehtë për të pasi që i pandehuri tjetër E.C. është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe mund të ketë lidhje edhe me persona tjerë nga Shqipëria, e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse po të gjendej i pandehuri në liri ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, koordinimit të deklaratave me të pandehurin tjetër, ndikimi në njëri tjetrin apo edhe në të pandehurit tjerë ngase nga ambalazhet e substancave narkotike kanë rezultuar gjurmët e gishtërinjve të A.G., i cili është ende në arrati, rrethana këto të cilat arsyetojnë drojën se me lënien e të pandehuri ne liri mund të vijë deri te pengimi i rrjedhës normale të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, e sidomos faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me substancën narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 55.60 kg, e cila është gjetur dhe konfiskuar nga Policia e Kosovës në veturën A. A 4 me targa ... të cilën e voziste i pandehuri A.B., lë të besohet se me lëshimin e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale.

Sa i përket pretendimit të mbrojtësit se i pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë dhe se tani nuk duhet të mbetet pezull gjersa të përfundojë çështje penale për të akuzuarin tjetër, ky pretendim nuk qëndron ngase ende ekzistojnë kushtet e lartë-cekura për vazhdimin e paraburgimit dhe se Kryetari i trupit gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor më datën 5.7.2017, me aktvendim ka shtyrë shqiptimin e dënimit për të pandehurin A.B., i cili e ka pranuar fajësinë dhe shqyrtimi gjyqësor do të vazhdojë për të pandehurin tjetër E.C.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.171/2017, më datë 17.7.2017

B. profesionale,
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa